



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**

Komisioni për Mandate, Imunitete  
dhe Rregullore të Punës  
Mbledhja nr. 7  
Prishtinë, me 27 tetor 2008  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

**P R O C E S V E R B A L**

**nga mbledhja e Komisionit për Mandate, Imunitete  
dhe Rregullore të Punës**

Në mbledhje morën pjesë: Ahmet Isufi, Kolë Berisha, Džezair Murati, Suzan Novoberdaliu, Ramadan Gashi. Hydajet Hyseni, Fatmire Berisha, Besa Gaxherri, Radmilla Vujoviç dhe Ismet Beqiri.

Nga zyra e NDI morën pjesë z. Reshit Gashi

Nga zyra mbështetëse mori pjesë: Nur Çeku, Antigona Ibraj.

Mbledhjen e kryesoi:  
Ahmet Isufi, Kryetar i Komisionit

Për këtë mbledhje është propozuar ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 26.09.2008**
- 3. Shqyrtimi i Draft Rregullores së Punës së Kuvendit**
- 4. Shqyrtimi për heqjen e mandatit të deputet z.Sabit Rrahmani**
- 5. Të ndryshme**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

### **2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 26.09.2008**

Procesverbali nga mbledhja e datës 26.09.2008, u miratua pa vërejtje.

### **3. Shqyrtimi i Draft Rregullore së Punës së Kuvendit**

Në lidhje me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes tha, ne e kemi para vetes edhe një draft propozim nga deputeti Xhavit Haliti, i cili nuk ka ndonjë ndryshim por vetëm janë hequr nenet që janë harmonizuar me Kushtetutë. Por ne do të punojmë nga drafti në të cilin komisioni e ka punuar deri më tani.

**Besa Gaxherri** tha, unë pajtohem me atë që e thatë ju zoti kryetar, dhe i falënderoi të gjithë ata që kanë bashkëpunuar me ne për hartimin e kësaj Rregulloreje, por mendoj se nuk është në rregull, që në kohën kur ne po duam me përmbyll këtë Rregullore, të sjellën propozime tjera, çoftë nga ndonjë anëtar i kryesisë, deputet apo organizatë ndërkombëtare, sepse edhe ashtu mendoj se jemi vonuar mjaft, për nxjerrjen e kësaj rregulloreje.

**Suzana Novobrdaliu** tha, unë mendoj se propozimi i Xhavit Halitit, tani për tani nuk duhet të shqyrtohet, por pasi të miratohet në komision dhe pas procedimit në seancë, gjatë shqyrtimit të dytë secili deputet mund ti jap vërejtjet e tyre.

**Ismet Beqiri** tha, edhe unë i falënderoi të gjithë për bashkëpunimin, por nëse ne kthehemi të shqyrtojmë secilin draft që na vjen, atëherë ne po vonohemi shumë. Deputetët mund të propozojnë në formë të amendamenteve prapë gjatë shqyrtimit në seancë plenare.

Kryetari tha, a pajtoheni që ne të punojmë në draftin që kemi punuar deri tani, e pastaj në seancë le të diskutoj secili deputet veç e veç.

Anëtarët e komisionit u pajtuan me këtë propozim.

**Hydajet Hyseni**, propozoi që në rregullën 5) të hiqen përkufizimet dhe të formulohet një rregull ku thuhet “shprehjet në këtë rregullore kanë kuptimin si në fjalorin e shprehjeve parlamentare që është bashkangjitur si aneks i veçantë i kësaj rregulloreje”, dhe pastaj ne duhet të punojmë që ta plotësojmë këtë fjalor.

**Besa Gaxherri**, propozoi që kjo rregull të mbetet kështu siç është, por të cekët që shprehjet tjera kanë kuptimin sipas fjalorit të shprehjeve parlamentare.

**Daut Beqiri**, i njoftoi anëtarët se, fjala është vetëm për shprehjet e përdorura në rregullore dhe jo për shprehjet tjera që përdoren në fjalorin e përgjithshëm parlamentar. Nëse komisioni konsideron se kjo duhet të hiqet, ose duhet me kërkuar referencë tjetër, atëherë është më mirë të hiqet krejt, se sa ti referohemi një dokumenti i cili nuk është zyrtar, sepse ai fjalor nuk është i miratuar në Kuvend. Kjo mund të bëhet si aneks i veçantë i rregullores, por që duhet të nënshtrohet miratimit në Kuvend, bashkë me rregulloren.

**Hydajet Hyseni**, tha unë nuk e kundërshtoj këtë që e thotë drejtori, është e vërtetë që ky fjalor nuk ka karakter zyrtar, por nëse Kuvendi e miraton këtë së bashku me rregulloren e zyrtarizon atë. Nuk po them se ky fjalor është i përkryer, por mendoj se ne mund të punojmë në një grup punues, që ta plotësojmë dhe ta harmonizojmë këtë fjalor, pastaj ta bashkëngjisim si aneks të veçantë në rregullore.

**Besa Gaxherri** tha, meqenëse ai fjalor nuk është zyrtar, atëherë këtij përkufizimi ti shtohet, që deri në miratimin e një aneksi të veçantë, shprehjet e përdorura kanë kuptimin si në fjalorin e shprehjeve parlamentare.

**Suzana Novobrdaliu**, unë mendoj se ky propozim i z.Hydajet Hyseni të mbetet, por pasi që z.Hydajet po thotë që ka gabime edhe në fjalor, atëherë të plotësohen ato gabime dhe pastaj ti bashkëngjitet rregullores.

**Fatmire Berisha**, unë kam një propozim kështu, shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin e përkufizuar sipas aneksit të veçantë të rregullores.

**Kolë Berisha**, propozoi që fjala kanë kuptimin të zëvendësohet me fjalën interpretohen.

**Ismet Beqiri** tha, nuk e di pse ne po bëjmë komente, kur komisioni mund të merr vendim për hartimin e një aneksi siç e propozoi z.Hydajet. Nëse duam ta bëjmë një aneks, atëherë mund të themi kështu: këto përkufizime dhe përkufizimet tjera parlamentare mund të rregullohen me një aneks të veçantë. Unë mendoj se këto që janë në rregullore, të përkufizohen këtu, sepse nëse nxjerrim aneks të veçantë, çdoherë mund të dalin edhe shumë shprehje të tjera.

Kryesuesi tha atëherë po e lëmë kështu: këto që janë i lëmë, por në fund ti shtojmë, shprehjet tjera parlamentare interpretohen sipas fjalorit të shprehjeve parlamentare.

**Daut Beqiri** tha, ne s'mund ti referohemi atij dokumenti sepse nuk është zyrtar, por nëse duhet të hartohet një aneks, ku do të përfshihen këto shprehje dhe shprehjet tjera parlamentare, atëherë kjo mund të mbetet si aneks i veçantë i rregullores që i nënshtrohet miratimit në Kuvend. Pra kjo rregull mund të përkufizohet kështu “ shprehjet e përdorura në këtë rregullore do të kenë kuptimin sipas shprehjeve të përkufizuara në aneks të veçantë të kësaj rregulloreje”. Pra le të na mbetet mua dhe z.Hydajet Hyseni, që të

punojmë në këtë aneks për shprehjet parlamentare, i cili do ti nënshtrohet miratimit në Kuvend bashkë me rregulloren.

Anëtarët e komisionit u pajtuan me propozimin e z.Daut Beqiri.

Gjithashtu gjatë këtij shqyrtimi kishte edhe disa propozime nga ICO-ja, të cilat kishin të bënin kryesisht me harmonizimin me Kushtetutë. Kryesuesi e njoftoi përfaqësuesin e ICO-së, se kjo rregullore është në përfundim të saj dhe se kjo rregullore në tersi është e harmonizuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Por nëse vërejmë se diçka nuk është përfshi atëherë do ti marrim parasysh propozimet e juaja.

**Besa Gaxherri** tha, unë edhe njëherë kërkoi, që në rregullore të mos figuroj shkelje e lehtë e shkelje e rënd e Kushtetutës. Ne kemi shembull konkret këto ditë më shkeljen që e ka bërë Presidenti i Kosovës, pra do të kemi dilemë se çka mund të llogaritet si shkelje e lehtë e si shkelje e rënd nga Presidenti. Prandaj unë insistoj që në rregullore, të thuhet vetëm shkelje e Kushtetutës, pastaj është Gjykata Kushtetuese ajo që vlerëson, se çfarë shkelje është bërë.

**Kryesuesi** tha, kjo rregullore është harmonizuar me Kushtetutë dhe mendoj se duhet të mbetet kështu siç është.

Pas leximit përfundimisht nen për nen, Komisioni për Mandate Imunitete dhe Rregullore të Punës së Kuvendit, ka miratuar Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Kryesuesi kërkoj nga stafi i administratës, që kjo formë e Rregullores, që është miratuar sot nga ky komision, të lekturohet, të përkthehen në gjuhën serbe ndryshimet eventuale dhe të procedohet për seancë.

#### **4. Shqyrtimi për heqjen e mandatit të deputet z.Sabit Rrahmani**

Kryesuesi njoftoi anëtarët e komisionit, se janë përmbushur kushtet, që deputetit Sabit Rrahmani, ti hiqet Imuniteti. Kryesuesi tha se deputeti në fjalë, i ka dërguar disa letra me të cilat ka dashur ta arsyetoi mungesën e tij. Por këto shkresa nuk mund të ndalojnë procedurën për heqjen e Imunitetit.

**Hydajet Hyseni** tha, ne e kemi bindjen se deputeti i ka plotësuar kushtet, por ne duhet të jemi konkret. Prandaj do të ishte mirë që ne ti kemi ato dokumente, në të cilat deputeti ka deklaruar që është nën kujdesin mjekësor, pra të mos veprojmë sipas bindjes sonë të lirë në të cilën jemi unanim. Juridikisht duhet të jemi në rregull.

**Besa Gaxherri**, juridikisht z.Hydajet Hyseni ka të drejt, edhe pse ne e dimë realitetin. Por kushtimisht nëse ai do të ishte i sëmur edhe pse realisht nuk është, atëherë kjo çështje prapë do të mund të merrej në shqyrtim.

**Kryesuesi** tha, bazuar në rregullën 14.3 të rregullores aktuale, deputeti Sabit Rrahmani i ka plotësuar kushtet për heqjen e mandatit. Ne gjithashtu kemi edhe kërkesën e Gjykatës komunale të Prishtinës si dhe kërkesën për heqjen e mandatit, nga partia prej nga vjen

deputeti. Pra kemi mjaft fakte dhe pastaj nëse, ka bazë tjetër për tu liruar z.Sabit Rrahmani, atëherë këtë le ta bëjë Kuvendi.

**Besa Gaxherri** tha, deputeti në fjalë realisht i ka plotësuar kushtet. Ne si komision e kemi obligim këtë çështje ta procedojmë në Kuvend, dhe pastaj Kuvendi le ta shqyrton rastin e tij dhe le të nxjerr vendim.

**Džezair Murati** tha, me këtë zotëri ne mund të merremi me muaj të tërë, sepse ai prapë do të sjell arsyetim e letra në gjuhën gjermane. Në të gjithë e dimë rastin e tij, prandaj mendoj se nuk është në rregull që të vazhdojmë të merremi me çështjen e tij. Ai i ka plotësuar të gjitha kriteret për heqjen e statusit dhe nuk kemi nevojë të humbim kohë me të.

Për këtë çështje komisioni vendosi: Ti Rekomandohet Kryesisë së Kuvendit dhe Kuvendit, për heqjen e statusit të deputetit Sabit Rrahmani.

## **5. Të ndryshme**

Në këtë pikë nuk pati çështje për diskutim.

Ahmet Isufi  
Kryetar i Komisionit për  
Mandate, Imunitete dhe Rregullore të  
Punës së Kuvendit

Përgatiti:  
Njësia mbështetëse e komisionit